



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogë Më/Dana 16-04-2024 vit/god.			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetësi Prilog	Vlera Vendnost
01-062/01-			347



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë


Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **IV** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **22.04.2024 (e Hëne)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektin e vjetër të komunës së Vitisë.
Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2024.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Viti, më 16.04.2024



Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E TRETË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **19.03.2024 (e martë)**, në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj. Majlinda Shabani, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, përfaqësuesi i OSBE-së! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Anëtares së re të komitetit i dëshirojmë punë të mbarë. Ju njoftoj që, kemi pranuar konfirmim të ligjshmërisë për vendimin për iniciimin e procedurave për hartimin e hartave zonale, të cilin vendim e kanë kthyer në rishqyrtim të ligjshmërisë e për të cilin nuk kanë dhanë arsye. Jemi në kontakt me ministrin se si me vepru, sepse nuk na kanë rekomandu, ndërsa për vendimet e tjera nuk kemi pranuar ende konfirmim. Para se me hi në rend të ditës hapi diskutim jashtë rendit të ditës. Me lejo edhe të ju uroj Ramazanin dhe ju dëshiroj të kaloni sa më letë.

z.Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Për në Kuvend du një dokoment se, kush është ai që ka lëshu leje për x kafes, e cila e ka blloku sheshin në Pozharan. Sot në shesh të Pozharanit nuk mundesh me hi prej hymjes së shkollës. E dinë edhe mësimdhënësit sun hin askush në shesh për shkak se një njeri me leje të caktuar që thotë e kam marr nga komuna, e kam lajmru edhe inspeksionin. Është këtu përfaqësuesi i inspeksionit. Jam ballafaqu edhe unë me atë familje. Kemi marrë edhe kërcnime, por megjithatë nuk jemi prej tyre që frigohe mi. Kërkoj prej komunës prej ekzekutivit. Kush është ai që e ka lëshu atë leje për me zanë sheshin në Pozheran. Po ju informoj që, pasi që e ka blloku ai e ka qitë atë rrethoj. Çka ka bë mundemi me shku me kqyr në vend të ngjarjes. Kanë fillu edhe tjetër. D.m.th, në qoftë se e lejojmë këtë brenda 6 muajve në Pozheran nuk ka me pas shesh. D.m.th ka me qenë i mbushur me kafe të zanta, dhe problemi dytë. Ne e dimë 2-3 vite sa i bënë në zyre. Ne kemi ngritë shqetësimin e shkollës së Pozheranit. Janë krenu kur e kanë kry punën që u bë dhe një prej seancave të KPF-së. E kam ngritë si shqetësim, është tu i kry punët një kompani e pandërgjegjshme. Kaluan 2 javë me një punëtor, është tu fshi, nuk e di qysh planifikoni me kry shkollën edhe atë punë që është tu e bë. Është mirë ne si Komunë, si Kuvend me formu një komision. Hajdeni kqyreni çka është ka bënë. Ne kemi pas një problem. D.m.th ajo kopmani na e ka kry stadiumin edhe kryesuesi ka qenë në vend të ngjarjes, dhe e falenderoj dhe harrova me përmend bojkotin që na keni bë në përdorim të stadiumit. Krejt subjektet politike, përveç kryesuesit që ka qenë nuk e di arsyen ku e keni pas, edhe hajdeni kqyreni çka ka ba te stadiumi. Qajo kompani e ka kry punën dhe tash ja kanë lanë edhe shkollën, edhe kush nuk merrë masa për ta me shku me kqyrë çka janë tu bë, është gjynah për ata fëmij, jemi tu i shti në një formë me u largu. Çdo ditë në shkollë të Pozheranit largohen nga 2-3 nxënës. Në qoftë se vazhdojmë me këtë avaz, nuk ka nevojë me ndërto shkollën e Pozheranit, se nuk ka me pas as nxënës. Llogariteni kur nuk ka nxënës në Pozheran, çka ndodh aty.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse ka leje e ka lëshu Drejtoria për Shërbime Publike që është kompetente me lëshu për shfrytëzimin e hapësirave publike. Nëse nuk ka leje inspeksioni duhet me vepru.

z.Jakup Demiri: Ilir, nuk e di as kur ka qenë loja me thanë të drejtën, (nuk dëgjohet). Shumë është e pavlerësime për do njerëz që me të vërtet nuk është në gjendje me ta bë një ftesë si duhet dhe delë fol këtu mu më kish ardh marre.

z.Ilir Zuka: Për çka, çka keni bë ju për stadium ne e kemi kry privatisht. Këtë nuk e ka kry Komuna e ministria, i kam dhanë 10 mijë euro me e lëshu stadiumin. Sa pare i paske dhanë ti Jakup që po thu i kemi dhanë zor e kemi kry privatisht. Jakup, e ka ndërpre Ministria.

z.Jakup Demiri: Krejt i kemi dhanë zorë. Prit ndëgjo, mësov me më respektu. E ki pas një far obligimi edhe kolegial me na fru qysh duhet jo qaty që ki fol në Kuvend, se tani mu kujtu që ki fol në Kuvend. Po qaq është e thjeshtë dhe joserioze, sa që as që e kam shti në krye. Kur të ma prush ftesën sikur për do sene, se tjera që bisedojmë ka qenë dashur edhe për këtë me bisedu, sepse ti nuk i ki ftu, kerkon siç duhet me i ftu.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndeje për të gjithë! Unë fillimisht uroj që mbledhjet e KPF-së me na shku mbarë e mirë. Edhe po besoj që ka me pas bashkëpunim të mirësjellt. Për mu është mbeldhja e parë e KPF-së. Natyrisht kam qenë e njohur ndoshta jo fizikish, po me temat që janë bë e diskutime që janë bë. Unë po shpresoj që kemi me pas bashkëpunim shumë të mirë dhe diskutimi ka me qenë natyrisht që në fund me mri diçka konkrete, që natyrisht është në të mirë të qytetarëve. Tek stadiumi i Pozharanti, ne nuk po pajtohemi edhe me diskutimet që po bëhen. Shpeshhere edhe me Ilirin ndoshta edhe në seanca të Kuvendit Komunal, sepse vazhdimisht kur të është fjala për Pozheranin, sepse e dimë që Pozherani është një prej lokaliteteve më të mëdha që i kemi në Komunën e Vitisë, edhe që ka pas disa probleme të vazhdushme, qoftë me shkollën e Pozheranit, stadiumin. Edhe sa i përket gjithë çështjeve tjera që janë ndërlihdh, dhe sa i përket meritave që gjithëmonë permenden, unë po potencoj që, natyrisht që ka qenë edhe obligim, qoftë qytetarë apo qoftë moral që ti mu marrë me çështjen, sepse edhe i takon atij vendi. Po natyrisht që gjithesecili prej neve po konsideroj që e kemi japë kontributin e mjaftushem për aq sa na ka taku dhe për aq sa i kemi kompentencat tona, që me bë diçka për zgjidhjen e atij problemi. Ne falenderojmë gjithsecilin qytetar i cili ka kontribu që, stadiumi më në fund ju ka kthi Pozheranit në formën që meriton e kam cekë edhe atë ditë pa dashtë me u përfshi në tema politike, mirpo sa i përket ftesës edhe unë po pajtohem që kur behet fjala jemi si institucin tash dhe natyrisht që ftesa ka qenë ftesë formale ose jo formale si do që të jetë por natyrisht që kishte me qenë e udhës edhe e mirë që ftesa me na u bë edhe në formë zyrtare qoftë edhe si grup i asambleistëve të VV sepse ne nuk hezitojm dhe nuk kemi hezitu as edhe një here me marrë pjesë kështu që po shpresoj që herave të tjera të kesh në konsiderat me na bë ftesë që natyrisht ne me ju bashkangjit ndeshjeve.

z.Ilir Zuka: Nuk e di problemin e Jakupit, unë jam falenderues për çdo njeri që ka ndiku për Pozheran. Jam kanë falenderues edhe ndaj deputetes Mirlinda Sadiku, se e di saktë çka ka bë për problemin e shkollës. Ndoshta ka qenë një nder të vetmet prej nivelit qendror që u marrë intezivisht me atë problematiken e shkollës, gjë që nuk mund me thanë nuk ka bë, se nuk është e ndershme, mirëpo kur po na konvenon kryesues, ne po thojmë ne jemi person zyrtar. Fjala jonë është në Kuvend. Nuk ka nevojë me bë kërkesë, se unë jam zyrtarisht këtu. E kemi cekë në Kuvend shumë here. D.m.th ju kemi drejtu ekzekutivit si unë si krejt aty, edhe unë kam llogaritë se ne nuk kemi bë diçka shumë të madhe, tu e ditë mënyrën si e kemi lëshu stadiumin, tu e ditë mënyrën qysh është shkëput kontrata ministri kompani. E dini edhe ju saktë. Ne kemi pas zyrtarisht një hapje të stadiumit. E dimë edhe firmat private sa kanë dhanë për me arritë me lëshu, se ajo ka pas mbetë një gërmadh. Është kanë rasti i njëjtë si i Vitisë, por ne kemi bë të pamundurën për mos me ndodh qëkjo mu kthi atje. E dimë çka kemi hekë edhe ne. Po unë kam llogaritë se, qata që e thashë atë, sepse asnjë njerit të vetëm asnjë ftesë nuk e kemi bë në mënyrën qysh po thuni ju. Ndoshta ka qenë gabimi jonë.

z.Jakup Demiri: E permende tash Mirlinden. Hera parë që e permende, se unë të kam pa edhe në kamera, se është njeri që më së shumti i ka dhanë zorë. Për stadium ministrin ta kemi pru në stadium, edhe ti kemi pre punimet. E dinë mirë me datë edhe këtu të kam përkrah për filan emrin që ti nuk i ke përmend. Kam folë edhe unë për të. Për senet çka i ki me vend të mbështeti.

z.Ramadan Deliu: Ata marrin rrogë për me i kry këto punë, mos kqyrni me marrë merita. Borxh ja kanë pas Pozheranit secili, si Mirlinda, si ai, si ky. Ato janë pare të popullit, me pare të popullit është ndreq.

z.Jakup Demiri: Qe Dan pse e përmenda, se ky e dinë në përrurim të stadiumit nuk e ka përmend as Mirlinden e ka përmend politiken e PDK-së në Viti. Kryetarin, Sokol Haliti fshatin e ka përmend, fshatit i ka dhanë Jehon vetëm qaty e kisha respektu. Prej meje kur kemi bisedu se, ky është njeri që më së shumti prej asamblistave mirret me fshatin e vetë si për shkollë si për stadium. Për stadium pak më pak, po për me i pre punimet ka qenë iniciativ edhe e jona, se qaty hala ish qashtu. Ne e dimë si ka shku në Viti puna e stadiumeve.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Në përrurim nuk ka pas as fjalim, veç e kemi kqyrë lojën. Ajo ka qenë pjesë e përrurimit. Thjeshtë unë i kam përshëndet. Pjesën që kanë dhanë kontribut vetanak për me përfundu, se nuk ish përfundu hala kjo.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Më lejoni që të ju uroj agjërim të lehtë dhe të pranuar. Në pyetjen e parë e cila është bërë, një dokument të cilën e ka lëshu Komuna, lejen, unë pajtoj aty me kryesuesin se e ka lëshu Drejtoria e Shërbimeve Publike, por po intereson emri kafes, se duhet me ditë me ju drejtu drejtorisë për cilën kafe është fjala. Shkolla e Pozheranit dhe kompania e cila punon aty, me sa kam informacion nuk është kompani që është fituse lidhse e kontratës. 99% është fjala për kompaninë që është nënkontraktore. Komuna duhet me bë presionin që unë konsideroj vazhdimësi, por edhe ministria e cila është edhe nënshkruese e kontratës mes kompanisë edhe ministrisë duhet të bëhet presioni nga pala e cila është nënshkruese e saj dhe ajo kompani besoj se i përshpejton punët dhe e ka në mbikqyrje edhe nënkontraktorin. Çështjen e cila u diskutu gjatë, ndoshta ka nxitë fjala bojkot që u quajt fillimisht që edhe unë nuk kisha mu pjatu. Ndeshjet e futbollit janë ndeshje. Ai që e gjanë veten ka kohë, shkon me shiku mundësinë. Nuk ka pas promovim të stadiumit, por ka qenë një lojë e cila e ka zhvillu klubi, prandaj askush nuk ka arsye me quajt na keni bojkotu, se futbolla është dëshirë e individit me qenë promovim i stadiumit, thirren me ftesa që tha edhe Jakupi, që e obligon ndesh subjektin, ndesh individin me qenë. Për kafiterinë do ti bëjë kërkesë Drejtorisë së Shërbimeve Publike ta shofë gjendjen. Në rast se leja është e leshume në përputhje me rregulloren e cila është në fuqi, atëhere plotësisht e ka detyrën zyrtari në përputhje me rregulloren, por në rast se leja nuk është në përputhje me rregulloren, unë besoj që planet të cilat i pengon kanë të drejtë me bë ankesë dhe ne e shfuqizojmë si shkallë e dytë kryetari i Komunës që është në këtë rast atë vendim dhe e lenë në gjendjen e mëparshme.

z.Illir Zuka: Veç të ju njotoj se, stadiumi "Ibrahim Kurtishi" ka hy në renovim me 3 mars 2018 dhe pas një pune të palodhshme të krejtve, ka arritë me u gjysmë përfundu me 3 mars 2024. D.m.th ky ka qenë fjalimi im në Kuvend dhe kam bë ftesë se po rikthehem pas 6 viteve në stadiumin "Ibrahim Kurtishi" për ta zhvillu ndeshjen e parë. Nuk e di çka do promovim tjetër hapja, ndoshta u dashtë me i marrë gershant me veti me pre ndonjë shirit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ama edhe bojkot, me i thanë dikujt të ka bojkotu. Nuk të ka bojkotu askush.

z. Fatlum Demiri, sekretar i Kuvendit Komunal Viti: Tek çështja që ngriti Iliri e ngriti plotësisht me vend. Sa i përket uzurpimit, unë e quaj uzurpim të trotuarit. Për fat të mirë prezent është edhe udhëheqësi i Drejtorisë së Inspeksionit, i cili ka qenë në teren. Nuk e di a ka leje, nuk e besoj që ka leje.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Fatlum, ti je jurist. Në në radhë të parë u shtru problemi. Ai është tu ba problem, është tu pengu. Sipas informacioneve, tash cila është detyra e ekzekutivit, me shiqu a ka leje dhe leja a është lëshu në konfrom të rregullores. Në rastë se nuk jan lëshu këto konfrom rregullorës, duhet me vepru Drejtoria e Inspeksionit, gjegjësisht Sektori i Uzurpimit dhe me kthy në gjendje të mëparshme.

z.Fatlum Demiri, sekretar i Kuvendit Komunal Viti: Plotesisht po, ka qenë dashur me intervenu para 3-4 diteve, nënkryetar ai ka bë investimin. Nuk po themë 100%, sigurt nuk ka leje. Ka leje gojore, leje me shkrim nuk ka. Momentin që ka dalë në teren Drejtoria e Inspeksionit, ka qenë udhëheqësi. A ka qenë drejtori a nuk ka qenë nuk e di, ka qenë dashur me vepru menjëherë, mos me lanë atë zotërinë me zanë trotuarin me shku me pa tash çfarë gjendje është trotuari në Pozheran, çdo moment rrezikohen fëmija. Një individ ka dalë përball një

komune. Nënkrjetar, po më vjen keq që po e ngriti këtë çështje, por shqetësuese është. Edhe nëse ka leje duhet me revoku lejen, duhet me anulë lejen.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Janë bē dukuri këto në Pozheran që duhet me i stopu. Unë e kam ngritë edhe para 3 jave që duhet me i stopu, por dikush ka thanë nuk duhet. Unë jam për me i stopu edhe këtë edhe atë tjetrën rend të gjithë ata të cilët janë pa leje. Leja është ajo e cila i mbulon të gjitha. Leja duhet me qenë e mbështetur në ligj dhe rregullore. Bazën ligjore, unë këtë jam tu e thanë dhe thamë vazhdimisht.

z.Illir Zuka: Një javë para se me vendos mu blloku krejt sheshi e kam njoftu drejtorin se, kam pas informacion se e ka dorëzë një kërkesë për leje. Momentin kur ka fillu me punu e kam thirrë drejtorin, nuk ma ka hap telefonin, e kam thirrë kryetarin, i kam thirrë këta djemtë e inspeksionit, tu ju falenderu edhe Arian Alidemen tek Zyra e Personelit ma ka siguru numrin dhe kam thirrë, por qasja e këtyre, e inspeksionit mua më ka pengë. Unë jam ballafaqu vetë me ta, e din përfaqësuesi, se tek e fundit kur është pronë publike, kur është e drejtë e qytetarëve për një person nuk lodhem, se tek e fundit qata qytetarë mua më kanë besu për me i përkrah. Çka më ka pengë te inspeksioni që thjoshin, ani, vendose njëherë ti qëtu tani e kqyrem. Nuk ka në Komunë të Vitisë as në Kosovë një njeri që e ka vendos e që ka dalë ju ka prishë edhe personi që po ja ceku fjalhtë e tij është këtu, thojke vendosi të këtu tani e kqyrëm. Mos e vendos se është pronë publike, edhe për atë që u cek më herët jo po bënë dallime këtij me ja dhanë këtij mos me ja dhanë, unë jam për krejt njëjtë, se në Pozheran fillimisht është bërë gabim kur i kanë leju kioskat me u vendos, se sa kanë pas të drejtë ai pa pas zyra ka pas Fatlumi, ka pas çdo qytetar i Pozheranit që i ka leju diku me i vendos kioskat, ti vendos, ti jo, është bërë dallime. Unë jam për me i liru krejt këto hapësira, sot nuk ka nevojë me u marrë emri i kafes. Dilni kqyrni rend i kanë mush kockat. Maksimum edhe 2 muaj nuk ki me pas shesh, është tu blloku i tëri. Unë jam ose me i liru krejt pronat publike ose zini krejt edhe u kry puna. Më kanë pengë fjalhtë e inspeksionit atë ditë, vendose qëtu tani e kqyrem. Dil ti tash prishe nëse mundesh me hekë. Hajdeni kqyreni kur të lëshohen nxënësat në ora 20 mbrajme kqyr qka bahet aty. Të paktën e kanë pas atë lidhje, e kan pre asfaltin dhe ka dalë, janë lidhë në shesh. Aty janë zebrat, nuk mundesh me dalë në shesh se është blloku. Unë e kam si problem me ngritë këtë, unë kam pas edhe kërcnime aty, po për fat të mirë që unë nuk bi pre e tyre, as nuk frikohem.

z.Faton Ahmeti, udhëheqës në Drejtorinë e Inspeksionit: Përshendetje për të gjithë! Iliri e ngriti si çështje, ne kemi qenë atë ditë, i kam qu edhe inspektorat e ndërtimit aty, jav ka prezentu një leje, ai djali një pagesë që e ka bē për 181 euro per qat hapësirën publike edhe ata e kanë bē një proces ata.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Nëse ai ka leje, unë e di që inspeksioni duhet me ju përmbajt lejes. Nuk guxon me ja prishë për sa meter katror ka leje, për atë duhet me ja leju, e nëse nuk ka pas leje, inspektori ka qenë dashur me e ndal punën menjëhere dhe mos me lanë me bē atë.

z.Illir Zuka: Ai nuk ka pas leje, jav ka prezentu një pagesë për kërkesë për leje edhe ju kam thanë nalne mos e lejoni me e ba, se tash sun e prishni. Këta sun e prishin tu i njoft këta sun e prishni. Ju kam thanë qitni shiritat, po ai nga ora 8 deri 11 të natës ka punu e ka qit kulmin.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Faton, e di që ti je frik në këtë detyrë, pagesa pason pas lejes së ndërtimit, duhet me pas leje të shfrytëzimit. Ai biznes ka qenë dashur me u pajis me leje, sa metra kator i lejohet për shfrytëzim të hapësirës publike dhe pasandej ai e bënë pagesën bazë të asaj leje dhe ky paska një fletëpagesë, e cila ndoshta është e vitit 2023. Kur ta ka prezentu pagesën ty, ka qenë dashur ti me e kërkë lejen 181 euro sa metra kator i kanë lëshu leje për shfrytëzim, në rast se ai e ka për shfrytëzim. Qeta ti tregon në leje edhe me çka e shfrytëzon me karrige me tendë e jo me hekra e me.

z.Faton Ahmeti, udhëheqës në Drejtorinë e Inspeksionit: Pagesa ishte e vitit 2024. Një ditë para se me shku inspektorët e kishte bē atë pagesë.

z.Jakup Demiri: Faton, nuk po ju njoft juve, po thojnë ka shkon rrota e parë shkon edhe e mbrapa. E kanë bē shesh këtu në Viti, sepse edhe këtu ne Viti e kanë pas zanë rrugën inspektorat, marrin rrogë, a punë nuk bëjnë hiq. Dalin në teren, bëjnë pazare, po ti je i ri e mos shko në rrugë të tyre.

z.Illir Zuka: Këta ka qenë dashur me dal në vend të ngjarjes për me pa qat tarasen që e ka bē ai. Taraza është e ndërtuar në pronë publike, nuk pagun taks komunale për tarasen. Hajde leje tarasen tash, e ka zan edhe komplet

këtë pjesën knej. Po du mu lidhë me Jakupin në vitin 2018 kur e kemi nis shveshtoren e stadiumit “Ibrahim Kurteshi”. Një javë ditë e kemi lut drejtorin e inspeksionit bashkë me punëtorë, nuk e kanë marr guximin me dal. Kemi dal ne vet si persona të klubit, e ku kemi pas konflikt me njerëzit që e kanë pas uzurpu aty këtë. Edhe kryesuesin e kam lutë atë ditë, qija shiritat mos e le me punu. Më ka thanë që puna ime është më shkru në fletore, shkrinë e zinë krejt, ama është problem kjo.

znj.Majlinda Shabani: Unë po besoj, pasi që i pasni këtu prezent nga Drejtoria e Inspeksionit, kjo ka me qenë ndoshta edhe një mesazh që me ja nisë që, përnime inspeksioni me e kry punën e vet siç duhet. Tash po i bjen që ne duhet me i pas nja 100 Ilira tjerë që me ardh me e adresu secilën çështje, e cila ndërlidhet me këto që janë pa leje. Nuk është fusha ime e nuk muj mu përzi në procedura, po atë që e kuptova prej këtu, që nuk kemi informacione bazike dhe nuk mudesh mu arsyetu me faktin që e ka ofru një dëshmi, që ka qenë fletëpagesë, sespe nuk janë përmend specifikat për çka, për çfarë periudhe kohore ose për çka është në shfrytëzim ajo, sepse tek e fundit kërkohet një llogaridhënie dhe këtu natyrisht fajtor është edhe ekzekutivi, sepse është pjesë përbërëse e saj. Këtë rast edhe nënkryetari duhet me marrë përsipër një pjesë të fajit. Sa i përket Drejtorisë së Inspeksionit, i cili nuk po e kryen punën si duhet, sepse në çdo fundvit neve na vjenë raporti i punës që ata e bajnë dhe përpos ndërtimeve pa leje, gjë që natyrisht që Komuna e Vitisë për mua është shqetësuse, sepse ka fillu me funksionu si lloj grupacioneve, ku gjithsecili vjen një biznesmen i njohur ka përfitim të vetin e merr në shfrytëzim një pronë publike dhe mandej lidhë si një lloj marrëveshje me kryetarin ose me një person të caktuar, i cili është person zyrtar në Komunën e Vitisë dhe pa marrë parasysh pjesën tjetër, që secili qytetar është taksapagues dhe natyrisht duhet me shfrytëzu komunën me atë që ju ofrohet, kështu që, unë po shpresoj dhe po besoj që edhe prej nënkryetarit po edhe prej gjithsecilit prej juve që qenkeni këtu me u përcjell ky mesazh, edhe që deri në fund të vitit unë personalisht po e marrë këtë si përgjegjësi. Natyrisht që edhe Iliri qenka këtu, jo vetëm për çështjen që e përmendi Iliri, po edhe shumë çështje të tjera të cilat lidhen me inspeksion dhe që duhet me u adresu, duhet me kërkë llogari për këto punë që nuk po kryhen dhe nuk po tregojnë profesionalizëm. Po e themë me keqardhje.

z.Faton Ahmeti, udhëheqës në Drejtorinë e Inspeksionit: Unë nuk thashë që ka përfundu ajo çështje, thashë i kam qu inspektorat e ndërtimit e kanë bënë një proces, ja u ka prezantu një fletëpagesë, ka metë me ardhë me pru vendimin ai djali vetë në inspeksion, e kemi marrë vullnetin, ka me pru vendimrin. Në bazë të vendimit si e tha edhe nënkryetari, aty ceken metrat edhe për çka është.

znj.Majlinda Shabani: A ja keni bënë me dije zotërisë që, nuk guxon me ushtru veprimtarinë përderisa kryhen këto procedura, sepse si po tregon Iliri, ai ka fillu veç.

z.Ilir Zuka: Jo, ai e ka kry.

z.Faton Ahmeti, udhëheqës në Drejtorinë e Inspeksionit: Ai e ka kry po ne nuk mundemi me nejt me rujt, ne i kemi thanë që mos puno.

znj.Majlinda Shabani: Jo me rujt, me ja ndalu, kjo është detyra juaj.

z.Ilir Zuka: Shkelje është vepër penale.

z.Faton Ahmeti, udhëheqës në Drejtorinë e Inspeksionit: Janë kanë inspektorët e ndërtimit. Tregova, ja u ka prezantu dhe vendimin, ka metë me pru në inspeksion.

znj.Majlinda Shabani: Dhe ai si në shtëpi të babës u qu e ka kry punën e vetë dhe në rregull jemi.

z.Faton Ahmeti, udhëheqës në Drejtorinë e Inspeksionit: Besoj që puna prej inspektorave është kry në mënyrën më të mirë.

z.Ilir Zuka: E qysh u kry në mënyrën më të mirë kur ajo është kry, u përfundu, është tu u shfrytëzu si kafe prona publike, ndërsa fëmija, njerëzit që dalin me hecë në shesh nuk kanë qasje, nuk mundën me hy në shesh, duhet me u sillë krejt në anë tjetër për me pas qasje me hy në shesh. Ti po thua e kemi kry.

z.Faton Ahmeti, udhëheqës në Drejtorinë e Inspeksionit: Ai e ka kry, po nëse nuk e ka në bazë të atij vendimi, në qfotë se nuk është përmbajt, atëhere ne bajmë ndryshe.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Është Ligji mbi Shfrytëzimin e Pronave Publike, është rregullorja e vitit kaluar për shfrytëzimin e hapsirave deri në afatin 1 vjeçar dhe çdo vit duhet të ketë leje. Unë mendoj që

është obligim i inspeksionit që, çdo pronë publike që shfrytëzohet tu fillu prej Vitisë e në çdo fshatë duhet të kontrollohet çdo ditë dhe të kqyren pjesët që shfrytëzohen, a shfrytëzohen konformë lejeve që i kanë të marra në Drejtori të Shërbimeve Publike. Çdo hapësirë që shfrytëzohet jashtë asaj duhet mirren masa prej inspeksionit, sepse është obligative me marrë masa. Faleminderit për çështjet që i ngritët, që po na përcjellin këto problematika në gjithë vendin, veçanarisht dhe në Viti. Materialin e keni marrë me kohë.

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjes së interesit në fshatin Budrikë Komuna e Vitisë për vendosjen të Bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë -Zona Ekonomike.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në shqyrtim publik draft rregullore për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punë së Subjekteve të Biznesit në Komunën e Vitisë.
5. Informatë nga zyra e prokurimit për raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2023

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: A keni me diskutu për rendin e ditës? Pasi që nuk ka, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Me ngritje të dorës: a jeni për miratimin e procesverbalit? Me të gjitha votat miratohet procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2.Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026

z.Besim Lubishtani, udhëheqës i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore: Përshendejte për të gjithë të pranishmit! Për shkak mungesës së zyrtares për barazi gjinore do ta paraqes propozim vendimin për Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026. Komuna e Vitisë ka ndjekur një metodologji gjithëpërfshirëse përmes këtyre hapave, d.m.th ka pas ngritje të gurpit punues për përgatitjen e këtij plani me urdhër të kryetarit të Komunës. Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzisutes, përcaktimi i fushave kryesore ndërhyrëse të domosdoshme për të përfshirë në Planin e Veprimit të Barazisë Gjinore 2024-2026. Konsultime paraprake brenda Komunës dhe hartimi i draft matrices të planit të veprimit të barazisë gjinore. Postimi në web faqen e Komunës, komente dhe sygjerime nga individët dhe grupet e interesit. Që të mos ju marrë kohë më shumë, materialin e keni marrë me kohë, për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. E di që Majlindë ke qenë edhe në diskutim publik, e di që kanë pas edhe disa punëtori që veç është punu si grup. Besoj që është bë një plan begi i mirë. Nuk ka plan që mund të jetë 100% komplant, por mjaftë i mirë në zbatim.

znj.Majlinda Shabani: Po, unë kam qenë pjesëmarrëse në takimin publik që është mbajtë me 20.03. Nuk kam qenë pjesë e punëtorive të cilat janë mbajt. Kam shpreh natyrisht gatishmërinë time në baza vullnetare, që sado pak me dhanë kontributin tim edhe kontributin si subjekt, si VV që kemi potencu atë ditë. Ibadeti nuk qenka këtu, por unë realisht du me përgëzu për punën e mirë që e ka bë. E kemi potencu edhe atë ditë, është një

plan, një strategji shumë e mirë e cila ka gjithëpërfshirje, edhe që brenga jonë mbetet se sa ka me u implementu kjo strategji, edhe natyrisht që edhe këtu kemi shpreh pak a shumë edhe shqetësimin tonë, se edhe financimi i strategjisë, një përqindje të madhe e shumicës së saj është prej organizatave joqeveritare dhe mandej pjesë tjetër shumë e vogël mbetet prej pjesës së Komunës. Andaj, edhe unë po shpresoj që edhe këtu Komuna ka me shpreh gatishmërinë e saj sa i përket aspektit financiar, sepse ka qenë një pyetje të cilën e kemi bërë, se sa është shuma që është llogaritur me kërkim prej Komunës, që me përkrah këtë strategji dhe sa ka gjetë zbatueshmëri prej planeve më herët, sepse natyrisht ne gjithmonë i fokusohemi planit paraprak që kemi pas, sa qaj plan ka arritur me u zbatu, mandej cilat kanë qenë sfidat që me pa edhe planin e ardhshëm. Kanë qenë të specifikume shumë mirë sa i përket të gjithave çështjet që i diskutove edhe ti. Ne i kemi pasë 3 propozime, unë mujta me pa tashti te specifikat ku është përmendur çështja e shëndetit. Kemi pas një propozim që të shtohet vetdijësi i vajzave për vaksinën HPV dhe rëndësinë e saj, sidomos nënat e vajzave të klasës së 6-të, sepse e dimë që është një vaksinë e re, që tash këtë vit ka fillu me u implementu, që është kundër kancerit të qafës së mitrës, ku tash veç edhe ministria po kërkon me u futë si informim, sepse shumë familjar nuk kanë qenë të informuar kur ka fillu me u dhanë kjo vaksinë, dhe e pashë që është përfshi. Natyrisht që po më vjen shumë mirë. Kemi pas një propozim tjetër, të mundësohet PAP testi për grat potent grupeve që janë të marginalizume, sidomos për ato grat që kanë psu nga dhuna në familje, dhunë seksuale, grat që janë vetushqyese, sepse ne edhe si asamblistë më herët kemi ngritur si çështje që është mirë me u mundësu me u bërë PAP testi për të gjitha grat e Komunës së Vitisë, por meqenëse nuk kemi kosto të mjaftushme, të paktën për këto grupet e marginalizume që janë me u mundësu ky lloj i PAP testit, mirëpo kjo nuk është përfshi dhe unë natyrisht që do insistoj, pasi kemi edhe nënkryetarin këtu dhe po besoj që edhe ti me përcjell këtë dhe me pa cilat janë mundësitë. Te çështja tejter që kemi cekë, është që, me u mundësu mësimi joformal për vajzat me aftësi të kufizume. E kemi një rastë në Komunë të Vitisë, po ja përmendi inicialet H.B, e cila ajo është me aftësi të kufizume, mirëpo sa i përket shëndetit mendor është shumë e aftë, sa që mundet me krye edhe punë dhe që kemi diskutu me të, pse nuk po ka qasje në mësim dhe arsimim, që natyrisht duhet me pas parasysh Komuna që me u mundësu mësimi joformal edhe për këto vajza të cilat janë me aftësi të kufizume. Këto kanë qenë 3 propozimet tona konkrete. Mandej kemi pas edhe diskutime tjera sa i përket zbatueshmërisë, andaj këto kanë. Çka dashta me shtu, që duhet prap me diskutu çështjen e mundësimit e PAPA testit për këto grat që janë të marginalizume. Sa i përket ftesës së informimit jemi në rregull. Shpresoj në fund që kjo strategji me u implementu dhe natyrisht që me u mbështet dhe prej Komunës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Me të vërtetë duhet me i përgëzu të gjithë ata të cilët kanë dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm. Dokument të përkryer kurr nuk ka, se koha e lindë një nevojë tjetër të cilët me të vërtetë duhet me u inkorporu, por megjithatë hapat të cilat janë ndërmarr dhe është bërë një dokument, unë konsideroj që është i rëndësishëm së veçantë, veçanti për Komunën e Vitisë. Në këtë rast Majlindë ajo që po thua, komuna duhet ta mbështet. Komuna e ka mbështet në momentin kur e ka caktu dikë për hartimin e saj. Vet ideja për këtë e ka mbështetjen e plotë. Tash në planin e veprimit këtu ka me pas nevojë për natyra të ndryshme të ndimesës, edhe tash në praktikë unë e di që nuk kemi me pas lehtë, por megjithatë të gjitha mekanizmat të cilët veprojnë në Komunë, d.m.th tu fillu edhe prej këshilltarëve, komisioneve. Unë besoj në momentin e hartimit gjithëhere duhet ta kemi një çështje, kujdes shumë here e thamë, unë dhe kryesuesi, prodhimi i dokumentacionit ka kosto buxhetore. Kosto buxhetore është kur ta bajmë hartimin e buxhetit, dhe unë konsideroj se atëhere është kontributi më i madh edhe i juaji edhe i joni, se edhe ekzekutiva mundet me i ikë prej mendsh, por jo rasisht formohen grupet. Grupa përshebull që ka qenë për hartimin e saj të tërhet thotë nënkryetar Kuvendi Komunal i Vitisë. Apo kryetar e ka prodhu një dokument të cilit ka kosto buxhetore 3 mijë dhe a i ke nda kodë buxhetor ndaj kod buxhetor. Dhe krejt kjo është ajo ndihmesa në këtë kod buxhetor do të ndihmohen grupi i atyre që i përmenda, se është për keqardhje, se është kategori shumë e dhimbshme të cilët kërkojnë gjithëhere mbështetjen e institucioneve dhe individëve, dhe jashtë institucionet të cilët kanë pak logjikë shoqërore të shnoh dhe besoj se kemi me bërë më të mirën të mundshme. Unë i përgëzoj gjithsecilin, se është një dokument shumë i gjatë, i madhë, një dokument të cilin ndoshta mund me pas ndonjë lëshim, por kryesisht prodhimi i dokumenteve të

tilla si qeveri komunale na gëzon, dhe vetëm ju urojmë edhe grupacionet tjera të kenë dokumente të kryera dhe nga puna të cilët ata e bajnë.

znj.Majlinda Shabani: Kisha dashtë me i bë dy dallime sa i përket hartimit dhe implementimit nënkryetar. Ne e dimë që komuna ka për obligim natyrisht që me bë hartimin, mirëpo nëse llogarisim këtë rast bëhet hartimi. Komuna nuk jep mbështetje financiare, mirëpo në këtë rast duhet me u përfshi dhe në implementim të kësaj strategjie, sepse ku po mbetet rëndësia e saj. Në fund po e bënë një dokument i cili ka shumë punë dhe shumë mund. Edhe sa i përket Ibadetit, por edhe gjithë personave të tjerë që kanë qenë të përfshirë, edhe unë realisht e përgëzoj për vullnetin që ajo ka me punu edhe përkundër rrethanave pamundësive që ja vështirësojnë punën e saj, që me gjetë implementim, mirpo këtu unë po insitoh që komuna duhet me qenë ajo e cila duhet me u përfshi në implementimin e specifikave të cilat janë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Veç Majlindë, ta kuptojmë që edhe Ibadeti është Komunë.

znj.Majlinda Shabani: Po Ibadeti është Komunë, mirëpo Ibadeti bënë kërkesë për mbështetje financiare dhe vendimin për mbështetjen mandej e merrë dikush tjetër.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ti je ajo që në shtator ki me votu një buxhet dhe kemi me caktu.

znj.Majlinda Shabani: Pikërisht për këtë nuk e kam votu dhe nuk e votoj në rast se buxheti vjen në këtë formë. Ti po delë në kundërshtim me veten, ti çka po thu është që Komuna ka dhanë kontribut me u bë hartimi. Vetë e the nuk e thashë unë. I bjenë që komuna ka dhanë kontribut me u bë hartimi. Ai hartim është kry, në momentin që kryhet, ai kërkon implementim, dhe implementimi mandej ajo mbetet pa u përfshi në aspektin e Komunës, në këtë rast komplet funksionimi i 70-80% që kemi parë edhe atë ditë që kemi pa gjatë diskutimit ka qenë prej organizatave jo qeveritare, ku bahet financimi janë të specifikume çështje shumë të rëndësishme. Sa i përket grave dhe vajzave dhe për atë po themë është një plan i cili është bë shumë i mirë, është një plan që ndoshta duhet me pas shembull edhe komunat tjera se si duhet me bë atë plan, mirëpo në rast se ajo nuk zbatohet, atëherë i hupë rëndësinë dhe pesha saj.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Qysh po konteston, pse pi bonë gjithë këto llafe shumë.

znj.Majlinda Shabani: Po kontestoj, sepse ti po thu komuna ka dhanë kontribut në hartim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po.

znj.Majlinda Shabani: Po ti e ke obligim me dhanë qatë kontribut.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ti po thu faleminderit shumë Komunës që e ke hartu, por pi thu tani e ftoj Komunën ne ta zbaton qysh njeri që e ka hartu ai ka për obligim me e zbatu, këtu e kemi unë e ti mospajtimin.

znj.Majlinda Shabani: Me çka të thashë me zbatu nënkryetar.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Me zbatu qatë planë në praktikë.

znj.Majlinda Shabani: Unë thashë me ofru mbështetje financiare, me nda buxhet për këtë strategji. Implementimi e përfshinë këtë. Këto janë fjalët e mia që jam tu i thanë, mandej mos të kapem në këto fjalë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Një duhet me kuptu, çka është për barazi gjinore binduni që këtu, është një keqkuptim, nuk është veç për gra, barazia gjinore i rrokë 2 gjinit. Jo vetëm këtu, po në nivel vendi, si të flasim për barazi gjinore mendojnë që jemi tu fol për gra. Barazi gjinore është barazi e përgjithshme. A jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend me ngritje dore? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkon në Kuvend kjo pikë

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjes së interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosjen të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë - Zona Ekonomike

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ju e dini se në seancën e kaluar e kemi formu edhe komisionin i cili do ta bënë ndarjen e tyre, por megjithatë në shqyrtim për shkak se kemi të bëjmë me një fakt industrial që ka datu me vite. Unë gjithëhere kam mendu që ka edhe këtë propozim vendim, se ky propozim vendim ndoshta u

dashtë me qenë para formimit të komisionit dhe kur e kanë marrë komisionin në shqyrtim e kanë pa se mungon kjo pjesë e vendimit, andaj është një kompletim i dokumentacionit që me i dhanë të drejtë komisionit me i hartu kriteret dhe me i bë thirrjen për konkurrimin e kompanive të cilat operojnë dhe veprojnë në Kosovë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend me ngritje dore? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkon në Kuvend kjo pikë.

Si pikë e katërt e rendi të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në shqyrtim publik Draft Rregullore për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punë së Subjekteve të Biznesit në Komunën e Vitisë

z.Dardan Zeqiri, përfaqësues i inspeksionit: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kjo rregullore është prej Drejtorisë së Inspeksionit, konkretisht prej 2 inspektorëve të tregut, andaj kjo rregullore e parasheh në detaje fillimin, mbarimin e orarit të punës në bizneset e Komunës së Vitisë. Gjithashtu edhe ditët e festave përpos të orarit të caktuar, në këtë rregullore kemi lanë hapësirë ose mundësi që me pas mundësi edhe blerësve me rritë orarin e punës me një taksë të paguar ditore ose mujore, e cila bëhet për Ministrinë e Financave, lëshohet leja nëse i plotëson kushtet. Gjithashtu këtë orar kemi parpa edhe gjobat nëse shkelet kjo rregullore, ku i kemi nda në 2 shkallë. Nëse biznesi bënë më shumë se 2 gjoba, atëherë gjoba tretë është më e lartë, e kemi bë një mundësi që nëse një biznes gabon më shumë se 2 here me u gjobit më shumë. Në pika të shkurta kjo është. Për çdo pakjartësi jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne parimisht në mandatin e kaluar kemi punu në këtë rregullore. Tash të njëjtën rregullore ja kam dorëzuar edhe drejtorit, tash sa u përmirësu, nuk e kam bë analizën. Kjo rregullore ka pas kalu në mandatin e kaluar edhe diskutimin publik, po në miratim e kemi stopu. Para se me hy në këtë, është dashtë me kanë një vendim edhe i drejtorit me emra të komisionit. Kush është komisioni që është në përpunim? Sepse ne nuk i kemi këtu e duhet mi pas si Kuvend, komisioni i cili është për hartimin e kësaj rregullores. Ne jemi tu e qitë në diskutim publik që është 30 ditë, mandej vjen prap në Kuvend. Tash cili komision e diskuton diskutimin publik dhe ato do ti paraqesin pjesën e diskutimit publik, takime me biznese. Hapi debatin.

z.Ramadan Deliu: Për këtë pjesë, për këtë thash me shti si pikë, ne ta rregullojm mirë. Tani kur e pash te biznesit, parukerit me punu, frizerat me punu, kafet me punu, autolarjet me punu kush mos me punu nëse bahet një vendim për mos me punu duhet me i lanë vetëm barnatore dhe një furrë. Nëse nuk bahet kjo prej nivelit qendor, në nivel komune kjo është problematike me u bë.

z.Illir Zuka: Dashta me u ndërlihdh me Danin. Edhe unë çka e kam shiku po bejshin ndarje më së shumti që po dëmtojshin më së shumti ishin ushqimoret, përndryshe kjo pjesa tjetër po punojshin. Unë e di kryesues edhe mandatin e kaluar kur kemi punu, kam qenë asistent i kryesuesit, me Fatlumin kemi qenë direkt të kyqt në ta. Aty u diskutu me marrëveshje me punu një barnatore, me punu një furrë e bukës, me bë me rend taman mu ditë që është ditë pushimi për të gjithë. Po mënyrën si ish këtu, këtu ish veç këto ushqimoret po fokusohen me i ndalë, tjerat po punojshin. Punojnë autolarjet, ndërtime, punojnë tjerat kush mos me punu. Në qoftë se e bajmë pushim të dielën, i lajmë vetëm ato që janë emergjente. E caktojmë ose e lajm për krejt me punu, se më doket po prekim biznese të caktume.

z.Ramadan Deliu: Drejtori më mirë ka qenë me bë një projekt, me bë një kërkesë me ndërto thertore, se po kryhet nëpër pazare kahmos.

z.Jakup Demiri: Kjo është hera parë që shkon në Kuvend. 1 muaj janë dëgjimet publike, kjo mundet me ndryshu. Kjo është puna që me ditë kush është bartës i saj shkon në Kuvend. Gjatë kësaj kohe me i dhanë shpjegimet mundemi edhe ne si asamblista me i marrë prej njerëzve të tjerë me i sjellë në debat.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po ju tregoj me sinqeritet, pa politikë. Majlindë, po më thua politikan, ama në këto çështje të cilat prej djehit e kam pas materialin në shtëpi, e kam analizu, nuk e kam stopu idenë e Taulantit që, ka qenë për me u ngritë kjo çështje. Veç ndëgjonem mirë, besoj që kjo rregullore do të na

shkakton revolt të bizneseve, pse Kllokoti është vetëm 6 kilometra prej Vitisë dhe ti ki me bartë konsumatorin në Kllokot, e mendon mirë. Disa komuna e kanë bërë në nivel të Republikës së Kosovës si ka shkrep nuk e di. Mendimi jem tu i pas krejt qëto rrethana nuk kam qefë me bartë prej këtu diku tjetër. Ndoshta e kisha mendu me stopu për momentin krejt, është mendimi im, as nuk po e themë si nënkryetar, jam tu e thanë si qytetar i Komunës së Vitisë.

z.Jakup Demiri: Këtë dashta me thanë, kur jemi marrë me Taulantin, se unë jam marrë me Taulantin me disa intervista me ndërmarrësit. Unë i kam diku 30 intervista me ndërmarrësit, 2 smun i gjanë që nuk janë të dielen me punu. Tash Taulanti nuk e di se sa dhe kemi pas lanë që, çdo biznes që është në Viti i regjistruar me vizitu me pyet. Kjo është me rëndësi me bërë nëse pajtohen bizneset dhe janë si janë kanë të atij vendimi. Unë mendoj që duhet me shty, se ata përimë nuk ishin që na thojshin nuk na prish punë, po ata dojshin me mbyllë të dielen mos me ardh na në punë. Bizneset që kanë realizim milionsh kanë një status tjetër.

z.Majlinda Shabani: Po nderlidhem me një temë tjetër, ku dush në shtetet të Europes. Nëse marrim shembull ose kudo tjetër është absurde mos me pas të paktën një ditë të javës pushim edhe unë këtu po e shofë njëfar mungese të vetëdijësimit edhe prej anës së bizneseve, nëse p.sh.: në këtë rast nuk pajtohen që të dielën me qenë ditë pushimi, është më njerëzore e pakta që munden me bërë të paktën një të diele me pasë pushim. Unë edhe në teren marketet që kanë qenë, shumicën e rasteve kemi ankesa edhe prej punëtorëve edhe për orarin shtesë që e kanë edhe që nuk ju paguhet e leje më një të diele që nuk e kanë pushim. Është punë fizike që bëhet dhe është punë që të lodhë dhe këtu është njëfar shkelje e të drejtave të njeriut, nëse flasim punon çdo ditë të javës dhe nuk e merrë asnjë ditë pushim. Shtetet e Europes janë tu e praktikë besa edhe metodën që me punu 4 ditë të javës, sepse po konsiderojnë që puna është më produktive edhe sjellë më shumë cilësi, dhe në rastë se në këtë rastë ne si Komunë nuk arrijmë që të paktën këtë me transpetu tek bizneset të cilat e kundërshtojnë që një të diele me pasë pushim, unë nuk po besoj që duhet me pas një biznes me konsideru që me shkelë një të drejtë të një njeriu. Mos me pas të paktën një ditë të javës pushim nëse qytetari konsideroj të paktën edhe qytetari e ka një të diele pushim, blerjet i bënë gjatë ditëve të tjerat të javës, qatë të diele e vendos me pas pushim dhe mësohet kjo praktikë sikur p.sh.: shkon me marrë një shërbim në Komunë e ke orarin prej mëngjes deri në ora 4, prej atij orari është i mbyllur, është i njëjti sen që praktikohet edhe në biznese, mirëpo forma ndryshon dhe qytetari mësohet me këtë praktik. E diela është pushim dhe duhet me u praktikë si pushim. Blerjet bëhen gjatë ditëve të javës. Tjera, unë po shpreosj që duhet me insistu, mirëpo forma dhe mënyra se si duhet me gjetë implementim, kjo natyrisht që duhet me pas diskutim më gjatë. Pajtohem edhe me Jakupin dhe gjithë këta tjerët që duhet me pas bashkëpunim, mirëkuptim me të gjitha bizneset me u përfshi, dhe në fund me arritë që me marrë këtë plan të rëndësishëm të Komunës.

z.Illir Zuka: Nuk e di Majlindë a me qëllim a pa qëllim e shtrembrove krejt ata çka e thamë ne. Qëllimi i gjithësecilit këtu ke, a vlenë për krejt. Nuk u diskutu a jemi pro a kundër. Qëllimi është që, në qoftë se ne nuk mundemi me i ndal bizneset e mëdhaja, i dëmtojmë bizneset e vogla. Në qoftë se e di që bizneset e mëdha me këtë vendim që e bjen komuna kanë me punu, unë jam kundër. Nuk e votoj në qoftë se e di. Në qoftë se është i njëjtë si për bizneset e mëdha si për të vogla, edhe unë jam për një të diele me pas pushim për krejt.

z.Jakup Demiri: A ka të drejt Komuna me ja ndalu Vives ose ETC të dielën mos me punu.

z.Dardan Zeqiri, përfaqësues i inspeksionit: Po ka autoritet, në Mitrovicë nuk ka punu deri frik "Viva", marketet e mëdha. E di që Iliri e ceku a janë biznese të mëdha a të vogla, këtu nuk ndahen, këtu janë përveç bizneseve, ato që jan prodhuse punojn dmth nuk kanë orar të caktum nëse nuk e prishin rendin dhe qetsin publike komplet biznet tjera përfshihen.

z.Illir Zuka: A vlen kjo rregullore edhe për sezonën e Verës edhe për dasma.

z.Dardan Zeqiri, përfaqësues i inspeksionit: Nëse nuk gaboj është e cekt.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne në bazë të përvojës e dimë që, një pjesë e bizneseve e kanë vetë një ditë pushim, e kanë të Premten pushim. Ne duhet me trajtu këtë çështje që, nëse e bajmë me ditë që ai nëse e ka të Premten pushim, atij biznesi i lejohet me punu të dielën, mirëpo unë mendoj që si rregullore është kërkesë e kahmotshme në Kuvend edhe prej Alisë, Taulantit edhe Jakupi këtu që u diskutu, ne duhet ta kalojmë ta qojmë

në diskutim publik. Punojmë në diskutim, ta kemi një rregullore edhe nëse nuk e miratojmë ta kemi të përafrome, por edhe nëse e miratojmë ne mund të mos e marrim vendimin, mos ta shtimë në fuqi deri sa ta shtinë komunat që janë në periferi. Unë mendoj që ky vendim duhet me u lidhë edhe me komunat që janë afër.

z.Jakup Demiri: Shembull, ku nuk pajtohem se kompania e cila e ka të Premten ose një ditë tjetër të punës. E diela nuk është pushim për kompaninë, është për punëtorin, është e drejtë e punëtorit me pas cilin do ditë, jo cilën të ja imponon.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend me ngritje dore? Me 6 vota pro, një votë kundër, asnjë abstenim shkon në Kuvend kjo pikë.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Informatë nga Zyra e Prokurimit për raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2023

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Përshendetje për të gjithë! Unë e bëj një raport të kontratave të nënshkruara publike për vitin 2023, e cila i përmban të dhënat rreth këtyre aktiviteteve, d.m.th nga titulli, planifikimi, nënshkrimi i kontratës, operatori dhe shënime tjera nuk po i lexoj krejt, se janë shumë. Për çka do që keni interes jam i gatshëm me u përgjigj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A janë të shënuara aneks kontratat këtu?

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Aneks kontrata është procedur e veçant, tash d.m.th u kanë brenda kontratës. Po me ligjin e ri shkon në kontratë në veti. Në atë raport janë krejt nëse ka një kontratë të tillë. D.m.th shkrin aneks.

z.Jakup Demiri: Kjo punë më e mirë ka qenë për Kuvend. Shembull, hartimi i projekteve investive kapitale në Komunën e Vitisë 360 mijë euro IAMAP SHPK.

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Ky është projekt 3-vjeçar.

z.Jakup Demiri: 36 me rend, 12 mijë e diçka ke për lula.

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Edhe kjo 3-vjeqare është, kemi pas çdo vjet, kjo është e parashikume se analizohet, mirëpo është 3-vjeqare.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Qysh e dimë ne këtë që është 2-3 vjeqare.

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Po i kemi ne në procedurë. Dokumentin e parë që e merrë menjëherë shkrinë 3-vjeqare. Kjo është e përafërt, e kemi bë 3 vjeqare, se çdo here e udhëheqim procedurën, tana nuk hargjohen shumë këto. Këtu hargjohet vetëm sasia për të cilën kemi nevojë. Përjashtimisht projektet të cilat janë që shkojnë, asnjë kontrat nuk shkon në fund. D.m.th nuk ka nevojë, ti e përmbyll vitin, ti nuk ke pas shpenzime (nuk dëgjohet mirë), duhet patjetër me u përmbyll një kontratë me çmim përveç projektit që duhet me u përmbyll, tjerat janë relative.

z.Jakup Demiri: Ndërtimi i hapësirave gjelbruese nr.48, këtu në Smirë nuk e di.

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Kjo është lidhë me këtë fundvit. D.m.th është punu në krejt këto fshatra varësisht prej saj që e ka përfundu menaxheri i kontratës dhe menaxheri me operatorin i caktojnë prioritetet, kështu që edhe kjo kontratë është 3-vjeqare. Nuk do të thotë që ka me u përmbyll, ka intervenime dhe ndërtime të hapsirave gjelbruese aty ku janë të parapamë.

z.Jakup Demiri: Këtu është edhe kjo me kalldrëm apo?

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Jo kjo është 2 vjeqare, është grand qeveritar (nuk dëgjohet është bërë debat direkt pyetje përgjegjje).

z.Fadil Abazi, përfaqësues i Zyrës së Prokurimit: Te kalldermi e kemi një problem, tek planifikimi dhe kemi ngecje për shkak se ja kam terhek vërejtjen. Për kalldrëm kam thanë me marrë praktika të tjera nga komunat që i kanë pas, mirëpo dikush e ka harru këtë edhe aty është harru njëfar material i langshëm si beton. Për mu kap ato tash nuk po mujmë m'ja nis me shtru sepse atë nuk e kemi, tash duhet me gjetë një zgjidhje për gjetë atë material. Jemi tu kqyr me gjetë një zgjidhje.

